Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0981
Data e Vendimit: 12.12.2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik ALTINN SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me mjete pune (Subvencione me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve)" me numër të prokurimit 615-23-6917-1-1-1, inicuar nga Komuna e Podujevës, në cilësinë e autoritetit kontraktues, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me datën 12/12/2023, mori këtë:

Vendim

1. **Hedhet e palejuar si e parakohshme** , ankesa e ALTINN SH.P.K. me nr. të protokollit 2023/0981, e datës 05/12/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mjete pune (Subvencione me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve)", me numër të prokurimit 615-23-6917-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E PODUJEVËS.

2. I lejohet, autoritetit kontraktues – KOMUNA E PODUJEVËS që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mjete pune (Subvencione me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve)", me numër të prokurimit 615-23-6917-1-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 05.12.2023 ka pranuar ankesën me nr.981/23 nga ALTINN SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mjete pune (Subvencione me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve)", me numër të prokurimit 615-23-6917-1-1-1, inicuar nga Komuna e Podujevës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

Komuna e Podujevëslidhur me aktivitetin e lartcekur me datë 10.07.2023 ka publikuar B05 - Njoftimin për kontratë ndërsa me datën 01.12.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë Arsimi sh.p.k.

OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit të AK me datën 05.12.2023 ora 09:28.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mjete pune(Subvencione me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve)", me numër të prokurimit 615-23-6917-1-1-1, Komuna e Podujevës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 10.07.2023 është publikuar B05 - Njoftimi për kontratë, me datën 01.12.2023 AK ka publikuar B58. OE ankues ALTINN SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit të AK me datën 05.12.2023 ora 09:28. Si dhe po të njëjtën 05.12.2023 ora 10.22 ALTINN SH.P.K ka parashtruar ankesë në OSHP, ende pa pranuar një përgjigje nga AK lidhur me parashtrimin e kërkesës për rishqyrtim.

Zyra për pranimin e ankesave, pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, ende pa pritur vendimin e AK rreth kërkesës për rishqyrtim i është drejtuar OSHP. Në të njëjtën ditë ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim pranë AK dhe ankesën tek OSHP.

OSHP sqaron se OE ankues ka qenë i obliguar fillimisht të paraqes kërkesën për rishqyrtim brenda afateve ligjore dhe konform dispozitave ligjore, me tutje pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes tek AK, ankesa duhet të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të nxjerrë nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së, në OSHP.

Neni 109 i Ligjit për Prokurim Publik përcakton se "*Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.*"

Po ashtu edhe neni 64.1 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik përcakton: "*Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të nxjerrë nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-se.*"

Konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 05.12.2023 nga OE ALTINN SH.P.K për aktivitetin e prokurimit me titull"Furnizim me mjete pune(Subvencione me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve)", me numër të prokurimit 615-23-6917-1-1-1, inicuar nga Komuna e Podujevës, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi nuk ka paraqitur ankesën në OSHP sipas dispozitave të lartcekura. Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore pranë AK, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së.

Si përfundim kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 108/A dhe 109 Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 64 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

I lejohet, autoritetit kontraktues – KOMUNA E PODUJEVËS që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mjete pune (Subvencione me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve)", me numër të prokurimit 615-23-6917-1-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vjosa Gradinaj
Kryetare e OSHP-së

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E PODUJEVËS**
- OE - **ALTINN SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: